

## **RELACION TEKNIK**

### **PROJEKTIM I OBJEKTIT :**

**”RIKONSTRUKSION I SHKARKUESIT KATASTROFIK TE DIGES  
SE REZERVUARIT KARROQ” BASHKIA FINIQ**

PROJEKTUESI

Ing. Gezim ISLAMI

## PERMBAJTJA

- 1) *PËRSHKRIMI I SHKURTËR I GJENDJES .*
- 2) *QËLLIMI I PROJEKTIT*
- 3) *OBJEKTIVAT*
- 4) *KËRKESAT*
  - a. *Inspektim vizual dhe përshkrim i gjendjes aktuale të skemës/ ujitëse.*
  - b. *Korografi*
  - c. *Planimetri*
  - d. *Relacion teknik*

## I. PËRSHKRIMI I SHKURTËR I GJENDJES

### Vendndodhja fshatit Karroq ,Bashkia Finiq

Kjo vepër ujitëse është ndërtuar në vitin 1963.

#### Treguesit teknik të tij janë:

- Kapaciteti sipas projektit  $V = 350\,000\text{ m}^3$  .
- Lartësia e digës  $H = 15\text{ m}$ .
- Gjatësia e kurorës  $L = 100\text{ m}$
- Ujëlëshuesi është me tubacion.
- Shkarkuesi katastrofik është sipërfaqësor.
- Diga është ndërtuar me material vendi.
- Mbushja me ujë bëhet nga pellgu ujëmbledhës

#### b) Gjendja fizike e digës dhe përbërësve të saj:

- Skarpatat nuk janë në gjendje të mirë pasi janë të mbuluara me shkure, repe e bimë të tjera.
- Shkarkuesi katastrofik ka gërryerje në pjesën e poshtme.
- Kurora e digës është në gjendje të mirë.
- Ujë lëshuesi nuk funksionon normalisht(eshte I bllokuar).
- Drenazhet e digës funksionojnë.
- Gjendja e brigjeve nuk është e mirë mbasi vazhdimisht ndodhin shkarje.
- **Saracineska e është e demtuar dhe duhet riparuar .**

Rezervuari është ndërtuar për ujitjen e 113 Ha tokë dhe është i vlefshëm për komunitetin e fshatit Karroq.

Foto nga situata e shkarkuesit.











## **II. QËLLIMI I PROJEKTIT**

Për të rivënë në punë rezervuarin dhe për të mos gjendur në situatën e vështirë të prishjes së tij. Pasi sot është shkateruar shkarkuesi katastrofik .

## **III. OBJEKTIVAT**

Objektivi kryesor është rritja e efikasitetit të objektit, parandalimi i ndonjë fatkeqësie natyrore dhe për të mos lejuar degradimin total të veprës.

## **IV. KËRKESAT**

Për objektin e përshfirë në këtë shërbim konsulenti është mbështetur:

### *1.1 Inspektim vizual dhe përshkrim i gjendjes aktuale të skemës/ ujitëse*

Përshkrimi përmban relacion shpjegues mbi mënyrën e funksionimit të skemës ekzistuese. Aftësia aktuale e skemave të ujitjes dhe kullimit. Treguesit teknik të tij.

Masat inxhinierike që propozohen për "Rikonstruksionin e shkarkuesit katastrofik të digës së rezervuarit Karroq".

### *1.2 Korografi*

Bashkëngjitur po paraqet një koreografi në shkallën 1:10,000 të gjithë zonës së fshatit Karroq e marrë nga Google Earth me koordinatën si më poshtë

39°44'23"N  
20°17'28"E

ku të tregohet dhe rruga që duhet të rehabilitohet për të krijuar mundësinë për furnizim me materiale të ndryshme dhe për levizjen e mjeteve të rënda.

### *1.3 Planimetri*

Konsulenti ka paraqitur një planimetri në hartë të shkallës 1:10 000 e shtrirjes së skemës:

- i) Emërtimin e objektit
- ii) Zonën ku bëhet rikonstruksioni, rrugët, fshatrat, qytetet, vepra dhe nën/veprat e saj.
- iii) Sipërfaqen që ujitet (që përmiresohet dhe që shtohet, futet rishat në ujitje apo kullim për çdo nënobjekt)
- iv) Profila gjatësor dhe terthor.
- vi) Zona e kanaleve ujitëse që do të trajtohen (Sh. 1:10,000)
- vii) Legjenden.

Planimetria është përpunuar edhe në versionin AUTOCAD

### *1.4 Relacion teknik*

Ky relacion ka trajtuar çështjet teknike që lidhen me digën e rezervuarit të Karroqit, funksionimin e saj dhe masat për përmirësim

## 2.1 Rilevimi

- i) relevimi me kuota i diges të përfshira në mirëmbajtje me një fasho të detyrueshme minimale 14m në të dy krahët e kanalit shkarkuesit;
- iii) profila tërthorë. Profili tërthor i zhvilluar me kuota në të dy krahët në të gjithë gjatësinë e fashës së përcaktuar më lart;

### *Volumet dhe Preventivi*

Konsulenti ka hartuar volumet paraprake për të gjitha kategoritë e punimeve të projektit. Volumet janë llogarit mbi bazë të vizatimeve të projektit. Çmimet njësi për punimet që përfshihen në preventiv janë llogarit sipas analizes së çmimeve që është në fuqi dhe e aprovuar nga qeveria (Çmimet sipas VKM nr. 216, datë 13.04.2023).

## 3 - Raportimi

Raportet dhe dokumentet janë në gjuhën shqipe dhe në katër kopje origjinale. Punimet janë të kompiuterizuara me metodat bashkohore (Word, Exel, AutoCad etj.)

Të gjitha fletët e projektit janë hartuar në format A-3 dhe përmbajnë detaje, shënime dhe tabela volumesh.

Nga vizatimet dhe volumet e punimeve janë hartuar preventivat për çdo nënobjekt dhe ai përmbledhës për të gjithë objektet që përmban detyra e projektimit.

PROJEKTUESI

Ing. Gezim ISLAMI